



Datë: 08.08.2025
Numër Protokolli: 5307/2025

A.nr.1141/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare; dhe Ardita Haxhnikaj Demi Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyll Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1141/2025, të datës 13.06.2025, të parashtruar nga ankuesi L.A, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*Kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa numër A.nr.1141/2025, e datës 13.06.2025, e parashtruar nga ankuesi L.A.

A r s y e t i m

Ankuesi L.A (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 13.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos kompensimit të funksionit shtesë i emëruar si anëtar i Komisionit për Monitorimin e Realizimit të Projektit për Subvencionimin e Granteve për NVM në kuadër të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë respektivisht në Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 10.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, (tutje referuar MINT), ndërsa kjo e fundit më datë 17.07.2025, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4010/2025 të datës 13.06.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Ref.12 Nr.07 të datës 02.04.2024; Vendimin Refd.12Nr.31 të datës 20.05.2024; Kërkesën e datës 30.04.2025 nga kryesues e Komisionit për Monitorimin e Realizimit të Projektit për Subvencionimin e Granteve për NVM; Emailin i datës 12.05.2025 nga Z.D për V.S; Emailin e datës 15.05.2025 nga Drejtori i Departamentit Ligjor; Emailin e datës 21.05.2024 nga ankuesi për S.B; Akt Emërimit e datës 21.05.2015; Vendimin e datës 12.04.2019; Vendimin e datës 20.05.2019; Diplomën me Nr. 443 të anliesit; Diplomën me Nr. 611 të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.07.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 17.07.2025; Emailin e datës 28.08.2024 nga R.B për Z.D; Emailin e datës

15.08.2024 nga Z.D për R.B; Emailin e datës 21.12.2023 nga Monitorimit KIESA për D.L; Kërkesë për udhëtim zyrtar e datës 25.02.2025; Formularin për pagesë retroaktive datës 07.03.2025; Kërkesën për udhëtim zyrtar datës 21.02.2025; Formularin për punë jashtë orarit të rregullt të punës datë 05.03.2025; Formularin për pagesë retroaktive datës 02.04.2025; Formularin për punën jashtë orarit të rregullt të punës datës 27.03.2025, 17.03.2025; Formularin për pagesë retroaktive datës 08.05.2025; Formularin për punën jashtë orarit të rregullt të punës datës 18.04.2025 dhe 07.04.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi, **është e pabazuar sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokolli 250 të datës 21.05.2015, mban pozitën Udhëheqësi i Divizionit për Komunikim me Publikun në MINT.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton se sipas Vendimit Ref.12 Nr.07 të datës 02.04.2024 të u.d Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovës, është formuar komisionin për monitorimin e realizimit t projektit për subvencionimin e granteve për NVM, kurse më datës 20.05.2024 përmes Vendimit Ref. 12 Nr.31 është bërë ndryshmi dhe plotësimi i vendimit të datës 02.04.2024, ku anëtari E.Sh është zëvendësuar me ankuesin.

Kryesuesja e komisionit për monitorimin e realizimit t projektit për subvencionimin e granteve për NVM, më datë 30.04.2025 i është drejtuar me kërkesë u.d Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovës, përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e shtesës për vëllim të punës, ndërsa u.d Drejtori i Përgjithshëm në Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovës më datë 12.05.2025 përmes emailit ka njoftuar kryesuesen e këtij komision se nëse zyra ligjore konfirmon se ekziston bazë ligjor dhe më pas nëse financat dhe sekretarja e konfirmojnë se ka mjete dhe gjithçka është në rregull atëherë edhe nga ana ime e mbështesë plotësisht kërkesën e juaj sepse e meritoni për punën që po bëni. Ndërsa Drejtori i Departamentit Ligjor në MINT përmes emailit të datës 15.05.2025 ka njoftuar u.d Drejtorin e Përgjithshëm në Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovës se lidhur me bazën ligjore të kompensimit të çështjes.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se është përkundër faktit që ushtroj një fundosin shtesë nuk më është bërë kompensimi në bazë të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publikë. Kërkon që të aprovohet ankesa të detyruar MINT që të aprovoje shtesën prej 20% mbi pagën bazë duke filluar nga data 20.05.2024.

Fillimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi gabimisht i është referuar Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publikë sepse kjo rregullore nuk ka të bëjë me këtë lloj kompensimi siç pretendohet nga ankuesi, ngase kjo rregullore ka për qëllim rregullat, mënyrën dhe procedurat e përfitimit të shtesave si: shtesës së performancës; shtesës të kushteve specifike të punës; shtesës për vëllimin e punës dhe shtesës për punën pa orar të paracaktuar, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me shtesë për vëllim në punës sepse me nenin 8 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publikë, është përcaktuar: 1. *Organizatat buxhetore, mund të japin shtesën për vëllim të punës, për kryerjen e punës për shkak të rritjes së vëllimit të punës, nëse kanë mjete në dispozicion për këtë qëllim nga kursimet e fondeve të pagave që krijohen për shkak të mungesës së nëpunësve civil, apo pozitive të paplotësuara për të cilat janë paraparë mjete në planin financiar të shfrytëzuesit buxhetor dhe fonde për projekte të veçanta*”, ndërsa në rastin konkret të

ankuesit kemi të bëjmë me emetimin e tij si anëtar i një komisioni që përbën funksion shtesë dhe në këtë rast aplikohen dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtesë.

Në kuptim të së drejtës së nëpunësi civil në kompensim për funksion shtesë, dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ju referua Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, gjegjësisht:

- Nenit 35 ku përcaktohet: *Kompensimet që mund të përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. kompensimi për kujdestari; 1.2. kompensimi për punë gjatë natës dhe jashtë orarit të punës; 1.3. kompensimi për punë gjatë fundjavës dhe ditëve të festave zyrtare; 1.4. kompensimi për udhëtime dhe shpenzimet e përfaqësimit; 1.5. kompensimi për funksionin shtesë; 1.6. kompensimi për anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm; dhe 1.7. kompensimi për stafin tjetër të administratës që punojnë jashtë vendit.*

- Nenit 38 ku përcaktohet: *1. Kur zyrtarët/ët publik, sipas legjislacionit në fuqi emërohen/caktohen që të shërbejnë në një bord, komision profesional apo organ tjetër publik që kërkon ekspertizë profesionale dhe përbën funksion shtesë për zyrtaren/in, ky/kjo zyrtar/e publik/e ka të drejtën e kompensimit shtesë për këtë funksion. 2. Kompensimi sipas pikës 1. të këtij neni nuk nënkupton detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pozita të cilën e mban zyrtarja/i publike, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit. 3. Kompensimi sipas këtij neni bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetaren/in dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët/ët, të pagës bazë së zyrtarës/it kryesor administrativ të institucionit në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik. 4. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet së paku një (1) herë në muaj, përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 5. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet më rrallë se një (1) herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 6. Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike dhe pas pëlqimit nga ministria përgjegjëse për financa, me akt nënligjor miraton kriteret për përfitim të këtij kompensimi.*

Po ashtu Kolegji ju referua edhe Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtesë, me theks nenit 4 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *Kompensimi për funksionin shtesë 1. Zyrtari publik i cili emërohet/caktohet që të shërbejnë në një bord, komision profesional apo organ tjetër publik që kërkon ekspertizë profesionale dhe përbën funksion shtesë për këtë funksion. 2. Kompensimi sipas pikës 1 të këtij neni nuk nënkupton detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pozita të cilën e mban zyrtari publik, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit...*” nenit 5 paragrafi 2 ku parashihet se: **2. Përrjashtimisht, kompensimi për funksionin shtesë mund të përfitohet kur plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme: 2.1. themelimi i Komisionit/Bordit parashihet në ligj apo akt nënligjor; 2.2. përfshirja në komision përbën funksion shtesë për zyrtarin publik; 2.3. funksioni nuk bënë pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën zyrtari publik e mbanë; 2.4. përfshirja në Komision kërkon ekspertizë profesionale të cilën zyrtari e posedon; 2.5. komisionet/bordet të cilat kanë kompetenca Vendim-marrëse në procedurë administrative; 2.6. komisioni/bordi nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar...**” si dhe nenit 7 ku përcaktohet se: *1. Kompensimi sipas këtij neni bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetarin dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët, të pagës bazë së zyrtarit kryesor administrativ të institucionit në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik. 2. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet së paku një (1) herë në muaj, përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 3. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni*

profesional apo organi tjetër publik mblidhet më rrallë se një (1) herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje në mbledhje.

Lidhur me këtë çështje juridike administrative, Kolegji mori parasysh edhe Qarkoren numër reference 355 të datës 22.03.2023, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me zbatimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë, e me të cilën është përcaktuar se: “... 3. Rregullorja ka përcaktuar kriteret për përfitim të këtij kompensimi, të cilat duhet të përmbushen **në mënyrë kumulative**: themelimi i Komisionit/Bordit parashihet në ligj apo akt nënligjor: 3.1.përfshirja në Komision përbën funksion shtesë për zyrtarin publik; 3.2.funksioni nuk bën pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën zyrtari publik e mban; 3.3. përfshirja në Komision kërkon ekspertizë profesionale të cilën zyrtari e posedon; 3.4.Komisionet/Bordet të cilat kanë kompetenca vendimmarrëse në procedurë administrative; dhe, 3.5.Komisioni/Bordi nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar... 8. **Në rastet kur përbërja e Komisionit/Bordi është nga institucione të ndryshme, kryesuesi dhe të gjithë anëtarët e Komisionit/Bordit kanë të drejtë të kompensohen, duke përfshirë edhe anëtarët të cilët janë të punësuar në institucionin që ka nxjerrë vendimin për themelimin e Komisionit/Bordit. Kjo vlen për Komisionet/Borde që janë tërësisht ndryshe nga përshkrimi i detyrave të punës - si p.sh Komiteti i Auditimit të Brendshëm, Komisioni për Vlerësim të Dëmeve të Shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore, Komisionet e ndryshme të themeluara nga Qeveria me përbërje të Institucioneve tjera. Ky kompensim nuk vlen për të gjitha Komisionet edhe sikur përbërja e tyre të jetë me zyrtarë të institucioneve të ndryshme, nëse në mënyrë kumulative nuk janë plotësuar kriteret e pikës 3. të kësaj Qarkore, rrjedhimisht edhe procedura e kompensimit është parapari sipas kësaj qarkoreje.**

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin se këto dispozita kanë përcaktuar kriteret se për tu kompensuar anëtarë apo anëtarët e një komisioni apo bordi në emër të funksioneve shtesë duhet të plotësohen të gjitha parakushtet ligjore së bashku si tersi, apo thënë ndryshe në frymën e normës juridike në mënyrë kumulative, ndërsa në rrethanat e rastit konkret dhe meqenëse është kontestuese nga pala në procedurë, konstatohet fakti se parakushti ligjor i përcaktuar në nën paragrafin 2.6 të nenit 5 të së njëjtës rregullore si dhe sqarimeve të dhënë nga Qarkorja numër reference 355 të datës 22.03.2023, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me zbatimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë, ka sqaruar se në rastet kur përbërja e Komisionit/Bordi është nga institucione të ndryshme, kryesuesi dhe të gjithë anëtarët e Komisionit/Bordit kanë të drejtë të kompensohen, duke përfshirë edhe anëtarët të cilët janë të punësuar në institucionin që ka nxjerrë vendimin për themelimin e Komisionit/Bordit e kjo vlen për Komisionet/Borde që janë tërësisht ndryshe nga përshkrimi i detyrave të punës - si p.sh Komiteti i Auditimit të Brendshëm, Komisioni për Vlerësim të Dëmeve të Shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore, Komisionet e ndryshme të themeluara nga Qeveria me përbërje të Institucioneve tjera, me çka nënkupton se në rastet e tjera nuk ka përcaktuar se mund të bëhet kompensimi, kështu që në rastin e ankuesit nuk janë plotësuar kushtet ligjore, ngase ankuesi është nëpunës civil në kuadër të MINT, kështu që komisioni ku ankuesi është caktuar si anëtar konsiderohet i themeluar nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar, ngase vendimi për formimin e komisionit për monitorimin e realizimit të projektit për subvencionimin e granteve për NVM është nxjerr nga u.d Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovës, andaj përkitazi me konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar dhe si rrjedhojë e njëjta është refuzuar.

Kështu që, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi dispozitivitet të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1141/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit L.A;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të MINT; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.